

RREGULLORE E AKTIVITETEVE KOMBËTARE TË BASKETBOLLIT



Përmbajtje

Neni	Përshkrim	Faqe
1	Pjesëmarrja në aktivitetet e FSHB	3
2	Aktivitetet kryesore të FSHB	4
3	Organizimi i aktiviteteteve	4
4	Sistemi i ndeshjeve	4-6
5	Regjistrimi	6-7
6	Kontratat, levizja e lojtarëve dhe trajnerëve	7-8
7	Mosha e lojtarëve, saktësimi i moshës limit	8-9
8	Hedhja e shortit	9
9	Orari i ndeshjeve	9
10	Detyrat e shoqatave pjesëmarrëse në aktivitete	9-12
11	Komisioni i disiplinës, protestat dhe ankesat	12
12	Paraqitja dhe sjellja e ekipeve në fushë dhe gjatë ceremonive të shpalljes së fituesve, vonesat në fillimin e lojës.	13
13	Sanksionet ndaj ekipeve, sjelljet jo sportive të publikut	13-15
14	Dënimet për sjelljet josportive të lojtarëve, trajnerëve, personave të tjerë	15-18
15	Gjyqtarët e lojës	17-18
16	Vëzhguesi	18-20
17	Gjyqtaria e tavolinës	20
18	Protokolli i ndeshjes	20-21
19	Dispozitat financiare	21-23
20	Anti-Doping	24
21	Etika	24-25
22	Dispozita kalimtare	25

Qëllimi i rregullores, të udhëzojë mbi veprimtarinë basketbollistike si edhe përshkrimet disiplinore, që lindin nga mos zbatimi apo përshtatja me këtë rregullore.

1. Kjo rregullore, ka për qëllim të rregullojë/orientojë ecurinë së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt, që është pjesë e aktiviteteve të FSHB-së, autoriteti që ruan ekskluzivitetin e zhvillimit, mbarëvajtjes dhe përfaqësimit të aktivitetit basketbollistik në Shqipëri e më gjerë (përsëkrhet në përcaktimet e kësaj rregulloreje.)
2. Implementimi i përcaktimeve të kësaj rregulloreje, që futet në fuqi nga koha kur ajo bëhet publike tek anëtarët e saj, është kusht i domosdoshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit basketbollistik. Rregullorja e aktivitetit, siç është bërë traditë, është sezonale, e ndryshueshme në varësi të problematikave dhe dinamikës së zhvillimit të aktivitetit. Sigurisht, gjatë sezonit në të cilin ajo është në fuqi, mund të lindin precedentë të paparashikuar, për të cilat organet përkatëse, do të marrin vendimet në përputhje me precedentët e krijuar më parë, në përputhje me rregullat që ata mund të formulonin për çështjen në fjalë.
3. Për rastin e situatave të paparashikuara në këtë rregullore, vendimet merren nga Presidenti i FSHB-së, dhe në mungesë të tij nga Sekretari i Përgjithshëm i FSHB-së.

Neni 1 Pjesëmarrja në aktivitet e FSHB

- 1.1 Sezoni sportiv zhvillohet gjatë periudhës **15 shtator** deri **15 qershor** të vitit pasardhës.
- 1.2 Aktivitetet kombëtare të basketbollit, janë të hapura për të gjithë anëtarët e F.Sh.B-së. FSHB informon shoqatat për detajet organizative në fillim të çdo edicioni sportiv.
- 1.3 Çdo shoqatë, ka të drejtë të marrë pjesë me një skuadër në çdo kampionat sipas rezultateve dhe formulave të përcaktuara.
Para dhe gjatë fillimit të sezonit sportiv, anëtari duhet të njoftojë zyrtarisht FSHB-në mbi logon, vendin ku do të zhvillojë ndeshjet si dhe sponsorët e çdo ekipi që do të regjistrojë. Çdo shoqatë/klub është e/i detyruar të deklarojë pranë FSHB-së, emrat e zyrtarëve të cilët janë të autorizuar për të nënshkruar dokumentacionin zyrtar të shoqatës/klubit që do të përfaqësojnë shoqatën/klubin dhe që do të mbajnë korrespondencën zyrtare me FSHB-në.
- 1.4 Anëtarët që kërkojnë të marrin pjesë në aktivitetet kombëtare të basketbollit duhet të paraqesin brenda afatit të përcaktuar nga FSHB-ja dokumentacionin dhe detyrimet sipas kërkesave të saj, formularin e regjistrimit të vulosur dhe të firmosur nga përfaqësuesi ligjor.
- 1.5 Në rastin kur një shoqatë ka depozituar dokumentacionet për anëtarësim konform ligjit të sportit dhe statutit të FSHB-së, si dhe ka marrë aprovimin nga KD-ja, pavarësisht se nuk ka fituar plotësisht statutisin e anëtarit, lejohet pjesëmarrja në aktivitet me statusin e shoqatës kandidate për anëtarësim.
- 1.6 Federata ruan të drejtën të mos pranojë regjistrimin e një ekipi që nuk plotëson kushtet e parashtruara në nenet 1.3 dhe 1.4.

Neni 2 Aktivitetet kryesore të FSHB

- Kampionati Kombëtar Meshkuj
- Kampionati Kombëtar Femra
- Liga Unike (M-F)
- Kupa e Shqipërisë Meshkuj e Femra
- Superkupa e Shqipërisë Meshkuj e Femra
- Kupa e Federatës Meshkuj e Femra
- Kampionati kombëtar U20 djem e vajza

- Kampionati kombëtar U18 djem e vajza.
- Kampionati Kombëtar U16 djem e vajza.
- Kampionati Kombëtar U14 djem e vajza.
- Kupa dhe turne të ndryshme për të gjitha grupmoshat nën 12 vjeç, etj.
- Pjesëmarrja me të gjitha këto struktura në aktivitete ndërkombëtare zyrtare dhe miqësore

Neni 3 Organizimi i aktiviteteve

- 3.1 FSHB-ja, ruan të drejtën e delegimit të organizimit të një aktiviteti lokal, kombëtar apo ndërkombëtar një anëtar i saj, pas një kërkesë me shkrim nga kërkuuesi dhe pasi të ketë shqyrtuar projektin/programin e depozituar për këtë qëllim.
- 3.2 Asnjë anëtar i FSHB-së nuk mund të organizojë ndonjë aktivitet lokal, kombëtar apo ndërkombëtar pa miratimin dhe delegimin e kësaj të drejte nga FSHB-ja.
E drejta e pjesëmarrjes të cilitdo anëtar të FSHB-së në garat e organizuara nga ajo, do t'i mohohet nëse rezulton të ketë detyrime të dokumentuara ndaj FIBA-s, apo ndonjë entiteti tjetër përgjegjës për organizimin e garave ndërkombëtare të basketbollit të njohur nga FIBA.
- 3.3 *Çdo shoqatë ka të drejtë të përfaqësohet me jo më shumë se një ekip në secilën grupmoshë (meshkuj/femra të rritur/a, U20 djem/vajza, U18 djem/vajza dhe U16 djem/vajza).

Neni 4 Sistemi i ndeshjeve

- 4.1 **Kampionati Kombëtar Meshkuj** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve që do të regjistrohen duke plotësuar kushtet e pjesëmarrjes.
- 4.1.1 Nëse do të regjistrohen më pak se **13 ekipe**, atëherë kampionati do të realizohet me 1 (një) kategori. Ndeshjet e sezonit të rregullt do të zhvillohen me sistem vajtje – ardhje. Pas realizimit të ndeshjeve të sezonit të rregullt do të realizohet faza e play-off ku ekipi i renditur në vendin e parë dhe të dytë do të kualifikohen automatikisht në fazën ½ finale. Ndërsa, ekipet e renditura nga vendi i 3 (tretë) deri në vendin e 6 (gjashtë) do të ndeshen për dy vendet e mbetura të fazës ½ finale sipas formatit 3 vs 6 dhe 4 vs 5, ku kualifikohen ekipet që arrijnë të fitojnë 2 (dy) ndeshje nga 3 (tre) të mundshme. Në fazën ½ finale ndeshjet do të zhvillohen sipas formatit 1 vs 4/5 dhe 2 vs 3/6, ku kualifikohen në finale ekipet që arrijnë të fitojnë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme. Seria e ndeshjeve finale do të fillojë në fushën e ekipit të renditur më mirë pas përfundimit të ndeshjeve të sezonit të rregullt (vatje-ardhje) dhe do të shpallet kampion ekipi që arrin të fitojë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme.
- 4.1.2 Nëse do të regjistrohen **13** ose më shumë ekipe, atëherë kampionati do të realizohet me 2 (dy) kategori, si më poshtë:
- 4.1.2.1 **Superliga meshkuj** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e **8 (tetë) ekipeve të përcaktuara në përfundim të sezonit sportiv pararendës**, ndeshjet e sezonit të rregullt do të zhvillohen sipas formatit me tre xhiro ku ndeshjet e xhiros së 3 (tretë) do të zhvillohen në fushën e ekipeve të renditura më mirë pas përfundimit të ndeshjeve në dy xhirot e para. Ekipi i renditur në vendin e parë dhe të dytë do të kualifikohen automatikisht në fazën ½ finale. Ndërsa, ekipet e renditura nga vendi i 3 (tretë) deri në vendin e 6 (gjashtë) do të ndeshen për dy vendet e mbetura të fazës ½ finale sipas formatit 3 vs 6 dhe 4 vs 5, ku kualifikohen ekipet që arrijnë të fitojnë 2 (dy) ndeshje nga 3 (tre) të mundshme. Në fazën ½ finale ndeshjet do të zhvillohen sipas formatit 1 vs 4/5 dhe 2 vs 3/6, ku kualifikohen në finale ekipet që arrijnë të fitojnë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme. Faza e play-off dhe finale do të fillojë seritë e ndeshjeve në fushën e ekipit të renditur më mirë në sezonin e rregullt sportiv, si dhe do të shpallen fitues ekipet që arrijnë të fitojnë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme. Ekipi i renditur i shtati ndeshet në play – out me të dytin e Kategorisë së I-rë, ku seria e ndeshjeve do të fillojë në fushën e ekipit të Superligës, si dhe do të shpallet fitues ekipi që arrin të fitojë 2 (dy) ndeshje nga 3 (tre) të mundshme. Ekipi i fundit bie në Kategorinë e I-rë.

- 4.1.2.2 **Kategoria e I-rë meshkuj** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve të regjistruara që nuk kanë fituar të drejtën për të luajtur në Superligë, me sistem rrethi, me vajtje – ardhje (sistemi i ndeshjeve do të përcaktohet nga FSHB, në varësi të numrit të ekipeve pjesëmarrëse) dhe faza e play – out-it (ekipi i renditur i dyti do të ndeshet me ekipin e renditur i pesti në Superligë)
- 4.2 **Kampionati Kombëtar Femra** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve që do të regjistrohen duke plotësuar kushtet e pjesëmarrjes.
Ndeshjet e sezonit të rregullt do të zhvillohen me sistem vajtje – ardhje nëse numri i ekipve të regjistruara do të jetë më shumë se 8 (tetë). Nëse numri i ekipeve të regjistruara do të jetë 8 (tetë) ose më pak, atëherë ndeshjet e sezonit të rregullt do të zhvillohen sipas formatit me tre xhiro ku ndeshjet e xhiros së 3 (tretë) do të zhvillohen në fushën e ekipeve të renditura më mirë pas përfundimit të ndeshjeve në dy xhirot e para. Pas realizimit të ndeshjeve të sezonit të rregullt do të realizohet faza e play-off me katër ekipet e renditura në vendet e para. Faza ½ finale do të zhvillohet sipas formatit 1 vs 4 dhe 2 vs 3, ku kualifikohen në finale ekipet që arrijnë të fitojnë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme. Seria e ndeshjeve finale do të fillojë në fushën e ekipit të renditur më mirë pas përfundimit të ndeshjeve të sezonit të rregullt dhe do të shpallet kampion ekipi që arrin të fitojë 3 (tre) ndeshje nga 5 (pesë) të mundshme.
- 4.3 **Liga Unike Meshkuj** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e 8 ekipeve, ku 4 ekipe janë nga Shqipëria dhe 4 nga Kosova. Ekipet e renditura nga vendi i I-rë deri në vendin e IV-rt të Kampionatit Kombëtar Meshkuj në edicionin e mëparshëm, janë të obliguara të marrin pjesë në edicionin pasardhës të Ligës Unike Meshkuj. Ekipet do të zhvillojnë veprimtarinë e Ligës Unike Meshkuj, mbështetur në rregulloren e sajë për këtë qëllim. FSHB akordon 5'000 euro për secilin e ekip pjesëmarrës nga Shqipëria, si mbështetje për shpenzimet e udhëtimit gjatë këtij aktiviteti. *Në rastet kur një ekip, që ka fituar të drejtën për të qënë pjesëmarrës në Liga Unike Meshkuj heq dorë nga kjo e drejtë, atëherë automatikisht e fiton të drejtën e pjesëmarrjes ekipi që është renditur më mirë në edicionin e mëparshëm. Ekipi që heq dorë nga pjesëmarrja në Ligën Unike do të fillojë Kampionatin Kombëtar Meshkuj me – (minus) 6 pikë ose do të paguajë një sanksionin financiar në shumën 5'000 euro. Gjithashtu nuk merr pjesë në ndeshjen e Superkupës, nëse është ekip pjesëmarrës në këtë veprimtari. Nëse një ekip tërhiqet nga aktiviteti i Ligës Unike Meshkuj pasi ka konfirmuar pjesëmarrjen në aktivitet, atëherë ekipi sanksionohet me shumën 20'000 euro.
- 4.4 **Liga Unike Femra** do të zhvillohet me pjesëmarrjen e 6 ekipeve, ku 3 ekipe janë nga Shqipëria dhe 3 nga Kosova. Ekipet e renditura nga vendi i I-rë deri në vendin e III-të të Kampionatit Kombëtar Femra në edicionin e mëparshëm, janë të obliguara të marrin pjesë në edicionin pasardhës të Ligës Unike Femra. Ekipet do të zhvillojnë veprimtarinë e Ligës Unike Femra, mbështetur në rregulloren e sajë për këtë qëllim. FSHB akordon 3'000 euro për secilin e ekip pjesëmarrës nga Shqipëria, si mbështetje për shpenzimet e udhëtimit gjatë këtij aktiviteti. *Në rastet kur një ekip, që ka fituar të drejtën për të qënë pjesëmarrës në Liga Unike Femra heq dorë nga kjo e drejtë, atëherë automatikisht e fiton të drejtën e pjesëmarrjes ekipi që është renditur më mirë në edicionin e mëparshëm. Ekipi që heq dorë nga pjesëmarrja në Ligën Unike do të fillojë Kampionatin Kombëtar Femra me – (minus) 6 pikë ose do të paguajë një sanksionin financiar në shumën 3'000 euro. Gjithashtu nuk merr pjesë në ndeshjen e Superkupës, nëse është ekip pjesëmarrës në këtë veprimtari. Nëse një ekip tërhiqet nga aktiviteti i Ligës Unike Femra pasi ka konfirmuar pjesëmarrjen në aktivitet, atëherë ekipi sanksionohet me shumën 20'000 euro.
- 4.5 **Kupa e Shqipërisë Meshkuj dhe Femra** zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve të regjistruara. Format i organizimit i Kupës së Shqipërisë Meshkuj do të jetë me turin eliminator për përcaktimin e dy ekipeve që do të formojnë ndeshjet ¼ finale me gjashtë ekipet e renditura më mirë në Kampionatin Kombëtar Meshkuj në edicionin në vazhdim deri në përfundim të fazës së parë.

Formati i organizimit i Kupës së Shqipërisë Femra do të jetë me turin eliminator për përcaktimin e dy ekipeve që do të formojnë ndeshjet 1/2 finale me ekipet e renditur në vendin e parë dhe të dytë në Kampionatin Kombëtar Femra **në edicionin në vazhdim deri në përfundim të fazës së parë.**

Turi eliminator dhe Faza ¼ finale do të zhvillohen me 1 (një) ndeshje në sallën sportive të ekipit të renditur më mirë në Kampionatet Kombëtare **në edicionin në vazhdim deri në përfundim të fazës së parë.**

Vendi i zhvillimit dhe datat për fazën Final 4 do të caktohen nga FSHB, pas shqyrtimit të kërkesave për organizim. Caktimi i çifteve 1/2 finaliste do të bëhet në bazë të formulës 1 vs 4 dhe 2 vs 3, sipas renditjes në Kampionatin Kombëtar **në edicionin në vazhdim deri në përfundim të fazës së parë.** Periudha e zhvillimit të Kupës së Shqipërisë është ndërmjet edicionit sportiv, **gjatë muajit shkurt** sipas kalendarit të përcaktuar nga FSHB.

Ekipet që nuk marrin pjesë në Kupën e Shqipërisë ose tërhiqen gjatë aktivitetit, gjobiten me 30'000 lek.

4.6 **Superkupa e Shqipërisë Meshkuj dhe Femra** zhvillohet ndërmjet ekipit fitues të Kupës së Shqipërisë dhe ekipit kampion/e të Kampionatit Kombëtar në të njëtin edicion sportiv. **Periudha e zhvillimit është pas përfundimit të Kupës së Federatës dhe përpara fillimit të kampionateve kombëtare,** vendi i zhvillimit dhe datat, do të caktohen nga Komiteti Drejtues, pas shqyrtimit të kërkesave për organizim. Nëse ekipi që ka fituar të drejtën e pjesëmarrjes në ndeshjen e Superkupës së Shqipërisë si ekip kampion/e, heq dorë nga kjo e drejtë ose e humb këtë të drejtë si rrjedhojë e mospjesëmarrjes në Ligën Unike, atëherë këtë të drejtë e fiton ekipi që është renditur më mirë në Kampionatin Kombëtar në edicionin e mëparshëm. Ndërsa, kur ekipi që heq dorë (ose humbet të drejtën e pjesëmarrjes) e ka fituar këtë të drejtë si ekipi fitues i Kupës së Shqipërisë, atëherë këtë të drejtë e fiton ekipi finalist i Kupës së Shqipërisë. Çdo rast tjetër do të trajtohet nga Komiteti Drejtues.

4.7 **Kupa e Federatës Meshkuj dhe Femra** do të zhvillohet me të gjithë ekipet që do të konfirmojnë pjesëmarrjen, **në rast se konfirmohet pjesëmarrja e të paktën katër ekipeve për secilën kategori,** sipas formatit të përcaktuar nga FSHB. Periudha e zhvillimit të Kupës së Federatës është në fillim të sezonit sportiv, përpara fillimit të kampionateve kombëtare.

4.8 **Kampionati kombëtar U20 djem, U20 vajza, U18 Djem, U18 vajza, U16 djem, U16 vajza, U14 djem dhe U14 vajza** zhvillohet me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve të shoqatave të regjistruara, me sistem vajtje – ardhje me një fazë dhe me Final Four (*Në rast se do të regjistrohen më shumë se 11 ekipe, atëherë kampionatet do të zhvillohen me ndarje në dy grupe, A dhe B, sipas përcaktimit me short. Në rastin e ndarjes me dy grupe, do të zhvillohet 1/4 finale ndërmjet katër ekipeve të renditura më mirë nga të dy grupet dhe Final Four.).

*Sistemi i ndeshjeve mund të ndryshojë në varësi të numrit të ekipeve të regjistruara, ku FSHB informon pjesëmarrësit përpara hedhjes së shortit.

4.9 **Turnetë e moshave nën 12 vjeç (U12 djem e vajza, U10 miks),** do të zhvillohen me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve të shoqatave të regjistruara, në bashkëpunim apo me delegim me shoqatat/klubet anëtare. Sistemi i ndeshjeve do të përcaktohet për çdo turne, në varësi të kushteve dhe pjesëmarrjes.

Neni 5 Regjistrimi

5.1 Një individ mund të zotërojë njëkohësisht më shumë se një licensë, vetëm në qoftë se kryen detyrën e lojtarit dhe trajnerit, brenda të njëjtës shoqatë, ose aktivizohet njëkohësisht me ekipin e meshkujve/femrave (të rritur/të rritura) dhe/ose U20 djem/U20 vajza, U18 djem/U18 vajza, U16 djem/U16 vajza, kundrejt një pagese 5 fishe për regjistrimin në ekipin e dytë dhe/ose të tretë. Një lojtar mund të regjistrohet në një ekip tjetër të shoqatës, në një kategori tjetër, pa paguar kuotën shtesë 5 fishe, pasi të

jetë ç'regjistruar nga ekipi ku ishte, brenda afateve dhe kundrejt tarifave të përcaktuara në këtë rregullore. Gjyqtarët e fushës, gjyqtarët e tavolinës dhe vëzhguesit, pajisen vetëm me liçensën përkatëse. Mjekët, fizioterapistët, mbajtësit e statistikave apo shoqëruesit, lejohen të qëndrojnë në stolin e të gjitha ekipeve të shoqatës, nëse janë në listën e ekipit (në stol lejohen jo më shumë se 18 persona, referuar rregullores së FIBA-s). Anëtarët e një shoqate/klubi apo personat e regjistruar nga një shoqatë/klub, pavarësisht pozicionit, mund të pajisen me liçensë, **vetëm** brenda shoqatës/klubit ku aderjnë apo janë regjistruar.

5.2 Ekipet që marrin pjesë në një aktivitet të federatës, duhet të plotësojnë formularin e regjistrimit me jo më pak se 10 lojtarë dhe jo më shumë se 18 lojtarë, të paktën një trajner (jo më shumë se 4 trajnerë) dhe jo më shumë se 5 shoqërues të ekipit. Me këtë formular duhet të pajisen të gjitha kategoritë.

5.3 Regjistrimi i lojtarëve/trajnerëve të ekipeve të meshkujve dhe femrave (të rritur/a dhe moshat), **bëhet përpara fillimit të kampionateve kombëtare sipas datave të përcaktuara deri përpara hedhjes së shortit, si dhe gjatë muajit janar** (ndryshime në lista duke shlyer detyrimet financiare sipas nenit 19). Kuota e regjistrimit/**transferimit** për çdo lojtar/e pas datave të përcaktuara për transferime gjatë sezonit sportiv në xhirot ku lejohen transferimet, krahas vlerave të përcaktuara sipas rastit të regjistrimit/transferimit, do kryhet pagesë shtesë sa 10-fishi i shumës së përshkruar në nenin 19.g.

Regjistrimet/**transferimet** për lojtar/e në ekipet e kampionateve kombëtare të rritur/a lejohen **deri në fund të muajit shkurt, sipas vlerave financiare të përcaktuara në nenin 19 dhe në nenet e tjera përkatëse të kësaj rregulloreje. Nga data 1 Mars deri dy javë përpara fillimit të Play-Off, lejohen transferimet, por me një vlerë financiare jo më pak se 5'000 euro.**

***Sqarim:**

Nëse një ekip dëshiron të transferojë një lojtar/lojtare gjatë periudhës nga 1 Mars deri dy javë përpara Play-Off, pavarësisht nëse detyrimet financiare sipas nenit 19 të Rregullores dhe nene të tjera (në varësi të rastit – transferimi i lojtarëve vendas apo të huaj) janë më të ulëta se 5'000 euro, atëherë ekipi do të duhet të paguajë një tarifë fikse prej 5'000 euro. Në rast se vlera e transferimit, sipas nenit 19 dhe neneve të tjera përkatëse të kësaj rregulloreje, kalon shumën prej 5'000 euro, atëherë do të aplikohet vlera e përcaktuar në këto nene, pa ndryshim.

Në kampionatet kombëtare U20/18/16/14 djem dhe vajza, pas muajit janar, lejohen regjistrime/transferime** të lojtarëve/eve deri përpara fillimit të xhiros së fundit sipas kalendarit përkatës të tyre.** *Në rastet kur kampionatet kombëtare të moshave fillojnë xhiron e fundit gjatë muajit janar ose më përpara, atëherë regjistrimet/transferimet e lojtarëve/eve lejohen në hapsirën deri në fund të muajit janar, por jo më vonë se dy javë përpara datës së fillimit të fazës finale.

Kuota e regjistrimit për çdo trajner pas fillimit të sezonit sportiv *(përfshijë hapsirat e përcaktuara për transferime) është 100 euro.

***Regjistrimet e lojtarëve/eve të cilët regjistrohen për herë të parë në basketboll ose janë pjesë e ekipit në listën e liçensimeve, lejohen deri përpara fazës finale të kampionateve kombëtare.**

5.4 Regjistrimi i lojtarëve të ekipeve U12 djem e vajza dhe U10 miks bëhet nga data 1 shtator deri 7 ditë kalendarike para aktivitetit të parë të sezonit në të cilin do të marrë pjesë ekipi. Për aktivitetet në vijim, do të lejohen regjistrime lojtarësh, kundrejt shumës së parashikuar në nenin 19.f.

5.5 Krahas formularit të regjistrimit, çdo ekip duhet të paraqesi, kartelat mjekësore individuale të sportistëve të lëshuara nga organet e specializuara shëndetësore sportive dhe siguracionin e specifikuar sportiv individual të lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve.

5.6 Lojtarët, trajnerët, personat që shoqërojnë ekipin, pasqyrohen me foton përkatëse në listën e federimit të miratuar nga FSHB Personat që nuk janë të pasqyruar në listë **nuk kanë të drejtë** të hyjnë në dhomën e ndërrimit të ekipit dhe/ose të qëndrojnë në stolin e rezervave gjatë ndeshjes. Çdo ekip është i detyruar të ketë me vete në çdo ndeshje, listën e federimit të miratuar nga FSHB Në listën e federimit do të përfshihet dhe shefi i delegacionit të ekipit i cili do të paraqitet në formularin e regjistrimit të dorëzuar nga titullari i shoqatës përkatëse.

Trajnerët regjistrohen në ekipet pjesmarrëse sipas kategorisë të licencës përkatëse, në përputhje me programin e miratuar të licencimit të trajnerëve.

Nuk lejohet që një trajner të regjistrohet në një edicion sportiv njëkohësisht në dy ekipe të shoqatave të ndryshme gjatë një sezoni.

Për kategoritë meshkuj/femra të rritur/a trajnerët duhet të zotrojnë nivelin PRO të licensës, në të kundërt FSHB-së i lind e drejta të mos pranojë kërkesën për regjistrim të trajnerit nga shoqata e interesuar.

Për trajnerët e huaj njihet Licensa ndërkombëtare e FIBA-s dhe/ose licensa e nivelit maksimal nga federata kombëtare e origjinës.

Neni 6 Kontratat, levizja e lojtarëve dhe trajnerëve

6.1 Anëtarët e F.Sh.B-së mund të lidhin kontrata me të gjithë lojtarët mbi 18 vjeç dhe trajnerët e tyre. Kontratat bëhen në tre kopje, një për shoqatën, një për lojtarin apo trajnerin dhe një depozitohet në FSHB. Kontrata mund të lidhin edhe lojtarët nën 18-vjeç nëpërmjet prindërve apo kujdestarit ligjor dhe menaxherit (n.q.s. ka).

6.2 Në rast se mes shoqatës dhe lojtarit/trajnerit nuk nënshkruhet kontratë, shoqata duhet të depozitojë në FSHB një deklaratë zyrtare, ku pranon se lojtarët/trajnerët, në mungesë të kontratës, janë të lirë të largohen kur të dëshirojnë për tu regjistruar me ekipet e shoqatave të tjera. Kjo deklaratë duhet të përfshijë listën e të gjithë lojtarëve/trajnerëve pa kontratë (n.q.s. ka).

6.3 Kontrata konsiderohet e vlefshme vetëm në rastet kur ajo bëhet sipas kërkesave ligjore dhe Statutit të FSHB-së. Në rastet kur ajo është e firmosur nga agjenti i licensuar nga FIBA, dhe kontrata është nënshkruar para se lojtari/a të ketë mbërritur në Shqipëri, në mënyrë elektronike, pranohet e përkthyer nga një përkthyes zyrtar.

6.4 Kur ka mosmarrëveshje përse i përket zbatimit të kontratës midis shoqatës/klubit dhe lojtarit/trajnerit, FSHB-ja njeh vetëm ato detyrime që janë të shkruara në kontratën e depozituar pranë FSHB-së.

6.5 Pas përfundimit të kontratës lojtari/trajneri konsiderohet i lirë dhe mund të transferohet në çdo shoqatë/klub tjetër, sipas dëshirës.

6.6 Gjatë kohës nën kontratë me një shoqatë/klub, lejohet kalimi i lojtarit/trajnerit në një shoqatë tjetër me leje kalimi (huamarrje) që depozitohet edhe në FSHB. Në përfundim të afatit, lojtari/trajneri është i detyruar të kthehet në shoqatën e mëparshme (huadhënës) deri në përfundimin e kontratës.

Huazimet lejohen deri më **1 shkurt** të sezonit përkatës.

- **Për huazimet ndërmjet ekipeve pjesëmarrëse në kampionatet kombëtare, aplikohen tarifat fikse si më poshtë:**

- **Lojtarët e huaj:** 1'000 euro për ekipet e meshkujve dhe 500 euro për ekipet e femrave;

- **Lojtarët vendas:** 30'000 lekë për ekipet e meshkujve dhe 15'000 lekë për ekipet e femrave.

Tarifat e mësipërme janë të detyrueshme dhe paguhet nga ekipi që merr lojtarin në huazim. Në rastet e huazimeve kombëtare, ekipi që jep lojtarin nuk përfiton asnjë vlerë takuese, ndërsa FSHB përfiton vlerën e plotë të tarifës së përcaktuar.

- **Për huazimet ndërkombëtare** (nga ekipe të federatave të tjera), tarifat financiare janë të njëjta me ato të transferimeve, të përcaktuara në **nenin 19**.

6.7 Për çdo transferim të një lojtari nga një shoqatë anëtare në një tjetër, gjatë kohës që është nën kontratë, paguhet në FSHB një tarifë transferimi (sipas nenit 19). Kjo tarifë është e detyrueshme edhe në rastet kur kontrata priset ose përfundon si dhe kur nuk është nënshkruar kontratë.

6.8 Kontrata bëhet për një periudhë jo më pak se deri në përfundim të sezonit sportiv në vijim. Në rast se një lojtar/trajner mbush moshën 18 vjeç ose i përfundon kontrata pasi ka filluar sezoni sportiv, shoqata mund të nënshkruajë me lojtarin/trajnerin një kontratë e cila duhet të zgjasë të paktën deri në fund të sezonit sportiv në vijim. Në rast të kundërt, shoqata/klubi duhet të lëshojë për këtë lojtar/trajner deklaratën e përmendur në nenin 6.2.

- 6.9 Lojtarët nën 18 vjeç (pa kontratë) mund të lëvizin nga një shoqatë/klub anëtar në tjetrin kundrejt një detyrimi financiar, duke bërë ndryshime në listën e regjistrimit. Për këtë kalim, paguhet në F.Sh.B një tarifë transferimi (shiko nenin 19).
- 6.10 Për transferimet e lojtarëve shqiptarë në klube të huaja dhe lojtarëve të huaj në klube shqiptare zbatohet Rregullorja e FIBA-s.
Për transferimin e lojtarëve të huaj në ekipet shqiptare duhet të kërkohet LOC (Letter of Clearance) në portalin FIBA MAP me formularin e përcaktuar për këtë qellim.
Në rastet kur FIBA refuzon LOC-në si rrjedhojë e informacionit të pa saktë nga shoqata që kërkon lojtarin, atëherë sanksioni financiar nga FIBA i ngarkohet shoqatës.
Në bazë të rregullores së FIBA-s, lejohen vetëm transferimet e lojtarëve që kanë agjent të licencuar nga ajo ose nuk kanë agjent. Në rast të aplikimit për transferim të lojtarëve me agjent të pa licensuar nga FIBA, atëherë FSHB është e detyruar që të mos kryej aplikimin e kërkuar.
- 6.11 Për lojtarët/trajnerët e huaj që regjistrohen në Shqipëri, kontrata është e detyrueshme. Ajo duhet të jetë e hartuar në dy gjuhë, shqip (për FSHB-në dhe shoqatën) dhe anglisht ose gjuhën e lojtarit/trajnerit të regjistruar (për lojtarin/trajnerin).
- 6.12 Në rast se një lojtar/trajner nënshkruan njëkohësisht dy kontrata apo nënshkruan një kontratë të re, afati i të cilës nis përpara përfundimit të kontratës ekzistuese, pezullohet deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve të përfshira.
- 6.13 Transferimi lojtarëve/lojtareve pa kosto financiare ndaj ekipit/shoqatës ku kanë qenë të regjistruar më parë dhe ndaj FSHB-së:
- 6.13.1 - **Statusi i lojtarit jo aktiv** – Çdo lojtar/lojtare shqiptar/e që nuk ka qenë i/e regjistruar në asnjë ekip dhe nuk ka marrë pjesë në aktivitete zyrtare të organizuara nga Federata Shqiptare e Basketbollit për të paktën dy (2) vite kalendarike, konsiderohet lojtar/lojtare jo aktiv/e.
 - 6.13.2 - **Transferimi i lojtarëve jo aktivë** – Nëse një lojtar/lojtare, i/e cilësuar si jo aktiv/e sipas pikës 6.13.1, kërkon të transferohet dhe të regjistrohet në një ekip tjetër, nuk aplikohet asnjë tarifë transferimi ndaj ekipit të mëparshëm dhe ndaj FSHB-së.
 - 6.13.3 - **Detyrimet kontraktuale** – Kjo dispozitë nuk cenon detyrimet kontraktuale që mund të ekzistojnë midis lojtarit dhe ekipit të tij/saj të fundit, në rast se ka marrëveshje të nënshkruara me afat të përcaktuar.
 - 6.13.4 - **Raste të veçanta** – Transferimet pa kosto aplikohen gjithashtu për:
 - Lojtarët/lojtaret e ekipeve që tërhiqen nga pjesëmarrja në edicionin aktual të kampionateve kombëtare për të rritur/a, të cilët në këtë rast konsiderohen lojtarë/e të lirë;
 - Lojtarët/lojtaret e shoqatave apo ekipeve që janë shpërbërë ose nuk kanë më veprimtari të njohur nga FSHB.

Neni 7 Mosha e lojtarëve, saktësimi i moshës limit

- 7.1 FSHB-ja zhvillon aktivitete për kategoritë e moshave nën 20 vjeç, të rinj/reja, para të rinj/reja, U14 djem e vajza, minibasket djem e vajza dhe U10 Mix.
- 7.2 Mosha limit për regjistrimin e lojtarëve në ekipe përcaktohet si më poshtë:
- | | |
|----------------------|----------------|
| a – U20 djem e vajza | - deri 20 vjeç |
| b – U18 djem e vajza | - deri 18 vjeç |
| c – U16 djem e vajza | - deri 16 vjeç |
| ç – U14 djem e vajza | - deri 14 vjeç |
| d – U12 djem e vajza | - deri 12 vjeç |
| e – U10 miks | - deri 10 vjeç |

- 7.3 Viti i lindjes që korrespondon me limitin e moshës së çdo grupi, përcaktohet mbështetur në vitin në të cilin përfundon aktiviteti (viti kalendarik i përfundimit të edicionit sportiv – mosha e lejuar = viti i lindjes së lejuar).

Neni 8 Hedhja e shortit

- 8.1 Në parim, hedhja e shortit të çdo aktiviteti, bëhet në zyrat e FSHB-së dhe në prezencën e përfaqësuesve të anëtarëve pjesëmarrës.
- 8.2 Data dhe vendi i tërheqjes së shortit u komunikohet pjesëmarrësve, nga FSHB-ja. Mënyrat e tërheqjes së shortit deklarohen nga FSHB.

Neni 9 Orari i ndeshjeve

- 9.1 FSHB-ja cakton orarin e ndeshjeve, i cili është i zbatueshëm për të gjitha ekipet.
- 9.2 Kërkesa për ndryshimin e orarit dhe/ose datës së ndeshjes duhet t'i paraqitet FSHB-së 7 ditë përpara datës së fiksuar. Që kërkesa të merret në shqyrtim duhet që të jetë me shkrim nga anëtari që kërkon ndryshimin bashkë me konfirmim me shkrim nga kundërshtari që është dakord, si dhe të kryhet pagesa në FSHB e një shume prej 1'000 lekë (për ndryshimin e orarit) ose 2'000 lekë (për ndryshimin e datës). Çdo kërkesë që nuk do të vijë në kohë dhe nuk do të shoqerohet me pagesën përkatëse, nuk do të pranohet, me përjashtim të rasteve të forcës madhore, për të cilat vendos FSHB
- 9.3 FSHB është i vetmi organ që ka tagrin për të ndryshuar vendin, datën dhe/ose orën e ndeshjeve. Për çdo vonesë në orarin e fillimit të ndeshjeve, FSHB mban qëndrim në përputhje me rregulloren.
- 9.4 Në zbatim të kalendarit të aktiviteteteve të basketbollit për sezonin sportiv, shoqatat anëtare do t'i zhvillojnë aktivitetet sipas deklaramit të sallave sportive të depozituar në FSHB përpara fillimit të kampionateve kombëtare. Nëse ekipi pritës nuk e ka të mundur të zhvillojë ndeshjen në sallën sportive sipas standarteve të përcaktuar atëherë duhet sigurojë një sallë tjetër sportive të miratur nga FSHB ku mund të realizohet ndeshja sipas datës së përcaktuar në kalendar.

Neni 10 Detyrat e shoqatave pjesëmarrëse në aktivitete

- 10.1 Anëtarët që marrin pjesë në një aktivitet të federatës, duhet të respektojnë dispozitat e kësaj rregulloreje. Çdo shoqatë/klub është përgjegjës për sjelljen e lojtarëve, zyrtarëve, antarëve, tifozëve, përkatës si dhe për sjelljen e çdo personi tjetër që ushtron ndonjë funksion në emër të shoqatës/klubit gjatë ndonjë ndeshje zyrtare.
- 10.2 FSHB-ja është i vetmi organ kompetent, që ka të drejtën legjitime, të miratojë ose jo zhvillimin e ndeshjeve në një sallë apo pallat sporti. Miratimi i vendit të zhvillimit të ndeshjeve do të bëhet nga FSHB-ja, 15 ditë përpara fillimit të aktivitetit, pasi të jetë bërë kontrolli i sallave të deklaruara nga anëtarët pjesëmarrës, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e përshkruara në rregulloren zyrtare të lojës (përmasat, pajisjet, ndriçimi, dhomat e zhveshjes, etj). Edhe pas miratimit të zhvillimit të ndeshjeve, shoqata organizatore duhet të garantojë mirëmbajtjen e ambienteve dhe mirëfunksionimin e pajisjeve. Mungesa ose mosfunksionimi siç duhet i pajisjeve apo ndriçimi i pamjaftueshëm, që çon në zhvillim jo normal të ndeshjes, gjohet me 5'000 lekë. Në rast se kjo shkakton moszhvillimin e ndeshjes, ekipi e humbet ndeshjen aforfe dhe gjohet me 100'000 lekë.
- 10.3 Të gjithë anëtarët, duhet të sigurojnë prezencën e forcave të ruajtjes së sigurisë (me uniformë), në numër të mjaftueshëm për të garantuar zhvillimin normal të aktivitetit (ndeshjes). Në rast se ndeshja nuk do të fillojë për shkak të mungesës apo numrit të pamjaftueshëm të tyre në orarin e përcaktuar në kalendar dhe vonesa e fillimit të lojës është 15 – 30 minuta, anëtari organizator dënohet me 5'000 lekë gjobë. Në rast përsëritjeje, gjoba dyfishohet. Në rast vonese mbi 30 minuta, ndeshja nuk zhvillohet, ekipi e humbet ndeshjen aforfe dhe gjohet me 100'000 lekë. Për aktivitetet e organizuara nga FSHB-ja, siguri i prezencës së forcave të rendit publik bëhet nga ajo.

- 10.4 Çdo shoqatë/klub duhet të sigurojë dhe të mbajë në gjendje funksionale 2 (dy) uniforma të ndryshme, një për ndeshjet në shtëpi (uniforma me ngjyre të hapur) dhe tjetrën për ndeshjet në transfertë (uniforma me ngjyrë të mbyllur). Duhet që uniformat të kenë të njëjtën ngjyrë mbizotruese të kanatieres dhe të shkurtrave. Këto duhet t'i deklarojë përpara fillimit të sezonit.

Asnjë nga uniformat nuk duhet të jetë e ngjashme si ngjyrë ose model me uniformat e zyrtarëve të ndeshjes. Uniformat e lojës së ekipeve, duhet të kenë të vendosur në pjesën e përparme majtas, logon e FSHB-së dhe në pjesën e pasme mbi numër, mbiemrin e lojtarit. Paraqitja e lojtarëve të ekipit me uniforma jo në përputhje me rregulloren, gjohet me 5'000 lekë. Nëse kjo bëhet shkak për zhvillim jo normal të ndeshjes, gjohet me 20'000 lekë.

Modeli i uniformave dhe paraqitja e lojtarëve në fushë duhet të jetë si më poshtë:



**Hapsirat e sponsorëve mund të jenë më të shumta, duke marrë miratimin e FSHB-së.*

- 10.5 Anëtari organizator, është përgjegjës për sigurimin e sallës së zhvillimit të ndeshjes (e miratuar nga FSHB), pritjen dhe përcjelljen e ekipit udhëtues, gjyqtarëve, vëzhguesve dhe të deleguarve të FSHB-së. Ai është përgjegjës për sigurimin e strehimit të tyre, në rastet kur ata e kërkojnë një gjë të tillë, kundrejt pagesës.
- 10.6 Anëtari pritës, organizator i aktivitetit (ndeshjes), është i detyruar të sigurojë mbajtjen elektronike të statistikave të të gjitha ndeshjeve të **Meshkujve dhe Femrave** (të rritur, të rritura). Këto statistika mbahen vetëm me programin e përcaktuar nga FSHB-ja (FIBA Live Stats). Statistikat duhet të mbahen LIVE nëpërmjet kodeve të mundësuar nga FSHB. Për mbajtjen e statistikave, duhet të angazhohen dy persona të trajnuar për detyrën e operatorit (Operator) dhe thirrësit (Caller). Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes (jo më vonë se një orë), personi i autorizuar nga shoqata për mbajtjen e statistikave (i çertifikuar nga FSHB-ja), dërgon elektronikisht në FSHB materialin përkatës. Në rast se statistikave të ndeshjes nuk mbahen, mbahen në mënyrë të parregullt apo nuk dërgohen saktësisht pranë FSHB-së, shoqata organizatore gjohet me 5'000 lekë.

N.q.s. skuadra udhëtuese kërkon të ketë një video të ndeshjes, atëherë ka të drejtën të regjistrojë zhvillimin e ndeshjes ku merr pjesë në audio dhe video dhe është i detyruar të përdorë materialin vetëm për qëllime të analizave sportive brenda klubit, dhe/ose për prova materiale për çështje të trajtuara pranë komisioneve juridike, **pa të drejtë transmetimi online ose në kanale televizive.**

Krahas statistikave, ekipi pritës duhet të dërgojë të paktën 10 foto nga ndeshja respektive, në adresën info@fshb.basketball, brenda 2 orësh nga përfundimi i ndeshjes, për pasqyrim në faqen zyrtare të F.Sh.B-së. Në rast se fotot nuk dërgohen, shoqata/klubi organizator gjobitet me 5'000 lekë.

Anëtari pritës, duhet të bëjë prezantimin e ekipeve pjemsarrëse në ndeshje, gjyqtarëve dhe vëzhguesit të emëruar për këtë qëllim, si edhe të garantojë ekzekutimin e himnit kombëtar përpara fillimit të ndeshjes (pas prezantimit). Në sallën sportive duhet të vendoset në menyërë të dukshme flamuri kombëtar shqiptar në përmasa minimale – 150 x 100 cm. Në rast se prezantimi nuk kryhet dhe/ose himni kombëtar nuk ekzekutohet, shoqata/klubi organizator gjobitet me 5'000 lekë.

10.7 Anëtari pritës, organizator i aktivitetit (ndeshjes), është i detyruar që të vendosë në pjesën e dukshme të tavolinës së gjyqtarisë së ndeshjes, logon e FSHB-së dhe të sponsorëve të saj, në të kundërt gjobitet me 5'000 lekë. Në rast përsëritje, gjoba dyfishohet. Në rast ripërsëritje, gjobitet me 20'000 lekë dhe pezullohet zhvillimi i ndeshjeve në sallën në fjalë, deri në zbatimin e këtij rregulli.

10.8 Anëtarët që organizojnë ndeshjet duhet të sigurojnë për ekipin udhëtues, gjyqtarët e lojës dhe vëzhguesin nga një ambient të përshtatshëm zhveshje. Mosvënia në dispozicion e dhomave të zhveshjes në kohën e duhur apo vënia në dispozicion e ambienteve të pa përshtatshme, gjobitet me 5'000 lekë.

10.9 Shoqata/klubi organizator duhet të vërë në dispozicion të ekipit mik pesë topa, të cilët do të përdoren për nxemje. Mos sigurimi i pesë topave për nxemje ekipit udhëtues 30 minuta para fillimit të lojës, gjobitet me 5'000 lekë.

10.10 Shoqata organizatore duhet të sigurojë vendet e mjaftueshme në tribunën VIP për zyrtarët e FSHB-së që kanë njoftuar prezencën.

10.11 Nëse mbrapa stolave të ekipeve ka shkallë për spektatorët, duhet të vendosen ndarje mbrojtëse (me strehë) për stolat e ekipeve dhe gjyqtarinë e tavolinës. Nëse ato mungojë, ekipi gjobitet me 5'000 lekë.

10.12 Shoqata organizatore duhet të ketë në gatishmëri para, gjatë dhe pas zhvillimit të ndeshjes dhomën antidoping.

10.13 Shoqata organizatore duhet të ketë në gatishmëri gjatë gjithë kohës së zhvillimit të ndeshjes, të paktën dy persona me detyrë fshirjen e parketit sa herë që gjyqtarët ta kërkojnë një gjë të tillë. Në të kundërt, gjobitet me 5'000 lekë.

Vlerësimin për mosrespektimin e kritereve të më sipërme e bën vëzhguesi ose në mungesë të tij, gjyqtari i parë.

10.14 Çdo ekip do të përballojë shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të tij.

10.15 Çdo ekip duhet të sigurojë vetë asistencën mjekësore. Mjeku ose fizioterapisti duhet të jetë i pajisur me licensën përkatëse.

10.16 Organizatori është i detyruar që për ekipin mik, të sigurojë deri 10 ftesa të cilat do të dorëzohen 48 orë para fillimit të ndeshjes apo me arritjen e ekipit në vendin e zhvillimit të ndeshjes.

Organizatori është i detyruar, që për të gjitha ndeshjet e basketbollit, të cilat organizohen në Republikën e Shqipërisë, që në kërkesë me shkrim të FSHB-së, të sigurojë 10 ulëse në vendin qëndror (hapsirën e caktuar VIP) dhe 15 ulëse në hapësirat e tjera, të caktuara për miqtë, anëtarët e Bordit dhe Sponsorizuesit e Ligave të FSHB-së.

Presidentit të FSHB-së, i takon ulësja qëndrore, në vendin qëndror të caktuar për personat VIP.

Organizatori është i detyruar, që në kërkesë me shkrim të ekipit mik dhe pas dhënies së pëlqimit me shkrim nga FSHB, 48 orë para fillimit të ndeshjes, të sigurojë deri në 15 % bileta (nga totali i sallës) për shikuesit e saj. FSHB mund të japë pëlqimin e saj ose jo, pas konsultimit me organet e sigurisë. Shoqata që bën kërkesën, mban përgjegjësinë për shikuesit e vet, dhe i nënshtrohen sanksioneve, sikurse edhe vendasi, për mos respektimin e rregullave të garës.

- 10.17 Ekipi pritës për kampionatet kombëtare të rritur/a duhet të sigurojë regjistrimin e ndeshjes në video me të paktën një kamer të vendosur widescreen duke filmuar të gjithë fushën e lojës dhe me pamje përballë stolave të ekipeve në ndeshje. Format i regjistruar në mp4 në cilësinë minimale me rezolucion Full HD:1080 HDTV (1080i, 1080p) me dimensioned 1920 x 1080 px. Nëse nuk realizohet filmimi, atëherë ekipi pritës gjohet me 10'000 lekë. Modalitetet për transmetim do të vendosen me procedurë të posaçme.
- 10.18 Anëtar i pritës, organizator i aktivitetit (ndeshjes) në kategorinë **U20/18/16 djem dhe vajza**, krahas mbatjes së Protokollit zyrtarë, është i detyruar të sigurojë dhe mbajtjen e protokollit dixhital në të gjitha ndeshjet sipas aplikacionit (InGame app) ofruar nga kompania NBN23.
- Në rast se statistikave të ndeshjes nuk mbahen ose mbahen në mënyrë të parregullt, shoqata organizatore gjohet me 5'000 lekë dhe në rast përsëritje ajo gjohet me dyfishin e shumës.

Shënim: Ekipi i shoqatës organizatore, nuk do të lejohet të marrë pjesë në aktivitetet e mbetura të sezonit sportiv në vijim, deri në shlyerjen e detyrimeve financiare. Ekipet e tjera të shoqatës nuk do të penalizohen deri në përfundim të sezonit sportiv. Pas përfundimit të sezonit sportiv, nëse detyrimi nuk është shlyer, asnjë ekip i shoqatës nuk do të regjistrohet për të marrë pjesë në aktivitetet e sezonit pasardhës, nëse më parë nuk shlyhen detyrimet financiare.

Neni 11 Komisioni i disiplinës, i apelit, protestat dhe ankesat

- 11.1 Komisioni i disiplinës dhe Komisioni i apelit janë kompetente për të vendosur të gjitha sanksionet ndaj një shoqate, ekipi, trajneri, zv/trajneri dhe/ose gjithë personave që bëjnë pjesë në një grup, në rast se shkelen rregullorja zyrtare e lojës dhe rregullorja e FSHB-së. Komisioni i disiplinës ka për detyrë të shqyrtojë disiplinën e lojtarëve, trajnerëve, ekipeve dhe gjithë personave që marrin pjesë në të gjitha aktivitetet zyrtare të FSHB-së. Sanksionet disiplinore që jepen nga FSHB-ja nuk përjashtojnë sanksionet që mund të jepen nga vetë shoqata ndaj ekipit, lojtarit, trajnerit, zv/trajnerit dhe gjithë personave të tjerë shoqërues të ekipit.
- 11.2 Në të gjitha rastet, protestat, ankesat dhe apelimet, ashtu si edhe pagesa e tyre e pa rimbursueshme, duhet të adresohen në FSHB.
- 11.3 N.q.s. një ekip mendon se, si rezultat i vendimeve të gjyqtarëve, janë prekur interesat e tij, ai ka të drejtë të protestojë për rezultatin e ndeshjes. Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, kapiteni i ekipit në fjalë, lajmëron gjyqtarët e lojës dhe vëzhguesin se ekipi i tij do të paraqesë një protestë dhe për këtë nënshkruan në vëndin e caktuar për protestat në protokollin e ndeshjes. Për këtë protestë, vëzhguesi vë në dijeni menjëherë përfaqësuesit e ekipit kundërshtar.
- 11.4 Deri në 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes, përfaqësuesi i ekipit i paraqet vëzhguesit (në mungesë të tij gjyqtarit të parë) protestën me shkrim.
- 11.5 Vëzhguesi dhe gjyqtarët e lojës do të bëjnë një raport të hollësishëm për përshkrimin e incidenteve për të cilat bëhet fjalë në protestë deri në një orë pas përfundimit të ndeshjes.
- 11.6 Që protesta të shqyrtohet nga komisioni i disiplinës së FSHB-së, duhet të shoqërohet me një pagesë 5'000 lekë
- 11.7 Vendimi i komisionit të disiplinës është në fuqi deri në momentin kur të ketë një vendim tjetër nga një organ më i lartë.
- 11.8 Kundër vendimit të komisionit të disiplinës, mund të apelohe brenda 72 orëve nga marrja e vendimit. Apeli duhet të adresohet pranë Komisionit të Apelit në FSHB dhe duhet të jetë i shoqëruar me vërtetimin e pagesës së shumës 10'000 në arkën e FSHB-së. Një kopje e kërkesës së apelit i dërgohet palëve. Komisioni i apelit trajton dhe shqyrton çdo vendim që është marrë nga komisioni i disiplinës dhe kontestohet nga palët e përfshira në vendim. Vendimet e Komisionit të Apelit mund të ankohen në KAS, (Këshilli i Arbitrazhit Sportiv).

Neni 12 Paraqitja dhe sjellja e ekipeve në fushë dhe gjatë ceremonive të shpalljes së fituesve, vonesat në fillimin e lojës.

- 12.1 Ekipi që, për çdo arsye, nuk do të paraqitet në një ndeshje, duhet të njoftojë urgjentisht FSHB-në si dhe ekipin tjetër, për mos paraqitje. Në rast se ekipi tjetër ose gjyqtarët janë nisur për udhëtim, anëtari organizator do të paguajë shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit (nëse ka).
- 12.2 Nëse një ekip arrin me vonesë në fushën e lojës për arsye jashtë vullnetit të tij, pasi ka njoftuar më parë për vonesën dhe kur është bërë ç'është e mundur që të arrihet në kohën e duhur, gjyqtari i parë duhet të zhvillojë ndeshjen duke relatuar për këtë fakt. Komisioni i disiplinës, në bazë të relacioneve të ardhura, do të vendosë për homologimin e rezultatit, anulimin e riluajtjen e ndeshjes apo humbjen aforfe të saj.
- 12.3 Kur një ekip paraqitet në fushë me më pak se 5 lojtarë, ai nuk mund të fillojë ndeshjen dhe do ta humbasë atë aforfe.
- 12.4 Kur një ekip paraqitet në fushën e lojës me më shumë se 15 minuta vonesë, pa shkaqe të arësyeshme dhe/ose pa lajmëruar për vonesën, gjobitet me 10'000 lekë. Nëse vonesa zgjat më shumë se 30 minuta, humbet ndeshjen aforfe, do të paguajë shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të gjyqtarëve dhe ekipit mik (nëse ka) dhe gjobitet me 100'000 lekë.
- 12.5 Në rast se një ekip nuk pranon të luajë apo largohet nga fusha e lojës në mënyrë demonstrative, e humbet ndeshjen aforfe dhe gjobitet me 500'000 lekë.
- 12.6 Në rast se një ekip qëndron në fushë pasiv, duke lejuar kundërshtarin të shënojë apo duke mos tentuar të sulmojë edhe pasi është këshilluar nga gjyqtarët, këta të fundit e ndërpresin ndeshjen dhe ekipi shkaktohet i kësaj situatë e humbet ndeshjen aforfe dhe gjobitet me 100'000 lekë.
- 12.7 Në rast se në përfundim të një ndeshje, do të zhvillohet ceremoni për shpalljen e fituesit të aktivitetit, ekipet janë të detyruara të marrin pjesë në të. Mosrespektimi i këtij rregulli (pjesëmarrja në ceremoni) gjobitet me 100'000 lekë.

Neni 13 Sanksionet ndaj ekipeve, sjelljet jo sportive të publikut

- 13.1 Në rast se një ekip meshkujsh ose femrash (të rritur) humbet dy ndeshje aforfe, përjashtohet nga aktiviteti, gjobitet me 500'000 lekë dhe sezonin e ardhshëm luan një kategori më poshtë.
- 13.2 Në rast se një ekip U20 djem ose vajza, të rinjsh ose të rejash (U18) humbet dy ndeshje aforfe, përjashtohet nga aktiviteti, gjobitet me 100'000 lekë.
- 13.3 Në rast se një ekip i moshave nën 16 vjeç (U16, U14, U12, U10) humbet dy ndeshje aforfe, përjashtohet nga aktiviteti, gjobitet me 30'000 lekë.
- 13.4 Kur një ekip meshkujsh ose femrash (të rritur) ka konfirmuar pjesëmarrjen në një aktivitet të F.Sh.B-së dhe pas hedhjes së shortit por përpara fillimit të aktivitetit, tërhiqet, dënohet me 200'000 lekë gjobë. Nëse tërhiqet pas fillimit të aktivitetit, gjobitet me 500'000 lekë, përjashtohet nga të gjitha aktivitetet e sezonit dhe sezonin e ardhshëm luan një kategori më poshtë.
- 13.5 Kur një ekip U20 djem, të rinjsh ose të rejash (U18) ka konfirmuar pjesëmarrjen në një aktivitet të F.Sh.B-së dhe pas hedhjes së shortit por përpara fillimit të aktivitetit, tërhiqet, dënohet me 50'000 lekë gjobë. Nëse tërhiqet pas fillimit të aktivitetit, gjobitet me 100'000 lekë dhe përjashtohet nga të gjitha aktivitetet e sezonit.
- 13.6 Kur një ekip i moshave nën 16 vjeç (U16, U14, U12, U10) ka konfirmuar pjesëmarrjen në një aktivitet të F.Sh.B-së dhe pas hedhjes së shortit por përpara fillimit të aktivitetit, tërhiqet, dënohet me 5'000 lekë gjobë. Nëse tërhiqet pas fillimit të aktivitetit, gjobitet me 20'000 lekë dhe përjashtohet nga të gjitha aktivitetet e sezonit.
- 13.7 Paraqitja në fushën e lojës e lojtarëve, trajnerëve, etj me mbishkrime në uniforma apo veshje të tjera, me përmbajtje fyese apo raciste, nëse konstatohet si veprim individual, gjobitet me 100'000 lekë dhe një vit mosaktivizim. Nëse përgjegjës për këtë veprim janë drejtuesit e shoqatës, shoqata gjobitet me 500'000 lekë.

13.8 Sanksionet ndaj organizatorëve të ndeshjes për sjelljet jospportive të publikut:

- a. Hedhje e përsëritur e objekteve të parrezikshme në fushën e lojës, para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
10'000 lekë
- b. Përdorimi i mjeteve tymuese që shkaktojnë ndërprerjen e përkohëshme të ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
10'000 lekë
- c. Përdorimi i mjeteve tymuese që çon në mosvijimin apo mosnisjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 50'000 lekë
Në rast përsëritje, zbatohen pikat 13.1, 13.2, 13.3
- ç. Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës, para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
30'000 lekë
Në rast përsëritje, 50'000 lekë
Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 100'000 lekë
- d. Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës që shkakton ndërprerjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
50'000 lekë
Në rast përsëritje, 100'000 lekë
Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 150'000 lekë
- dh. Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës që çon në mosvijimin apo mosnisjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 50'000 lekë
Në rast përsëritje, zbatohen pikat 13.1, 13.2, 13.3
- e. Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës që shkakton dëmtime të pjesëtarëve të ekipeve (lojtar, trajner, etj) apo personave në detyrë (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj para, gjatë ose pas ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
Dy ndeshje pa spektatorë, 100'000 lekë
Në rast përsëritje, 200'000 lekë
Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 200'000 lekë
- ë. Hedhje e objekteve të rrezikshme në fushën e lojës që shkakton dëmtime të pjesëtarëve të ekipeve (lojtar, trajner, etj) apo personave në detyrë (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj dhe çon në mosvijimin apo mosnisjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 100'000 lekë
Në rast përsëritje, zbatohen pikat 13.1, 13.2, 13.3
- f. Hyrja e spektatorëve në fushën e lojës para, gjatë ose pas ndeshjes (pa u larguar ekipet dhe gjyqtarët), në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
10'000 lekë

- g. Hyrja e spektatorëve në fushën e lojës që çon në ndërprerjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
- 50'000 lekë
- Në rast përsëritje, 100'000 lekë
- Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 150'000 lekë
- gj. Hyrja e spektatorëve në fushën e lojës që çon në mosvijimin apo mosnisjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
- Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 50'000 lekë
- Në rast përsëritje, zbatohen pikat 13.1, 13.2, 13.3
- h. Ushtrim dhune i spektatorëve ndaj pjesëtarëve të ekipeve (lojtar, trajner, etj) apo personave në detyrë (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj) para, gjatë ose pas ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
- 100'000 lekë
- Në rast përsëritje, 200'000 lekë
- Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 300'000 lekë
- i. Ushtrim dhune i spektatorëve ndaj pjesëtarëve të ekipeve (lojtar, trajner, etj) apo personave në detyrë (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj) që çon në ndërprerjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
- 150'000 lekë
- Në rast përsëritje, 250'000 lekë
- Në rast ripërsëritje, tre ndeshje pa spektatorë dhe 350'000 lekë
- j. Ushtrim dhune i spektatorëve ndaj pjesëtarëve të ekipeve (lojtar, trajner, etj) apo personave në detyrë (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj) që çon në mosvijimin apo mosnisjen e ndeshjes, në një ndeshje të organizuar nga një shoqatë anëtare:
- Humbje e ndeshjes aforfe, dy ndeshje pa spektatorë, 200'000 lekë
- Në rast përsëritje, zbatohen pikat 13.1, 13.2, 13.3

Shënim: Deklaratat e anëtareve të Komitetit Drejtues, për të gjitha problemet e ndodhura në ndeshjet e basketbollit, quhen të mirëqëna dhe do të merren parasysh nga komisioni i disiplinës. Ekipi i gjobitur për një shkelje të caktuar, nuk do të lejohet të marrë pjesë në aktivitetet e mbetura të sezonit sportiv në vijim, deri në shlyerjen e detyrimit. Ekipet e tjera të shoqatës nuk do të penalizohen deri në përfundim të sezonit sportiv. Pas përfundimit të sezonit sportiv, nëse detyrimi nuk është shlyer, asnjë ekip i shoqatës nuk do të regjistrohet për të marrë pjesë në aktivitetet e sezonit pasardhës, nëse më parë nuk shlyhet ky detyrim.

Neni 14 Dënimet për sjelljet josportive të lojtarëve, trajnerëve, personave të tjerë që qëndrojnë në stol apo personave drejtues të shoqatës.

- 14.1 Gabim teknik i lojtarit:
- 4'000 lekë
- 14.2 Gabim perjashtimi i lojtarit:
- 10'000 lekë
- 14.3 Gabim teknik i trajnerit:
- 10'000 lekë

- 14.4 Gabim perjashtimi i trajnerit ose stolit: 15'000 lekë
- Shënim:** Gabimet teknike të dhëna ndaj personave që qëndrojnë në stol i ngarkohen trajnerit, masa e dënimit është 4,000 lekë.
- 14.5 Reagimi i lojtarit me sjellje josportive pas dënimit me gabim perjashtimi: 12'000 lekë
- 14.6 Reagimi i trajnerit me sjellje josportive pas dënimit me gabim perjashtimi: 15'000 lekë
- 14.7 Sjellje josportive e lojtarit ndaj shikuesve të ndeshjes: 15'000 lekë
- 14.8 Sjellje josportive e trajnerit ndaj shikuesve të ndeshjes: 20'000 lekë
- 14.9 Sjellje josportive e lojtarëve, trajnerëve apo personave të tjerë që qëndrojnë në stol (fyerje, kërcënime, etj) të cilat nuk janë ndëshkuar nga gjyqtaret gjatë ndeshjes si edhe pas përfundimit të saj, por paraqiten nga vëzhguesi: 10'000 lekë
- 14.10 Deklaratat fyese të personave drejtues të shoqatave, trajnerëve, lojtarëve apo personave të tjerë që qëndrojnë në stol, të cilat dëmtojnë imazhin e FSHB-së, të bëra publikisht në media apo rrjete sociale: 100'000 lekë
- 14.11 Realizimi i sulmit në ndeshje e trajnerit nën ndikimin e alkoolit si dhe lejimi i pjesëmarrjes në ndeshje apo qëndrimit në stol të lojtarëve dhe personave të tjerë nën ndikimin e alkoolit, pas testit të kontrollit që rezulton mbi 0.02 %: 30'000 lekë
- 14.12 Sulmi fizik ndaj kundërshtarëve (lojtar, trajner, etj), spektatorëve, pjesëtarëve të ekipit të tij, zyrtarëve të ndeshjes (gjyqtarë, vëzhgues, gjyqtarë tavoline, etj), apo pjesëmarrës të tjerë në ndeshje, para, gjatë ose pas ndeshjes: Përfundim jo më pak se 6 muaj nga aktivitetet dhe 100'000 lekë
- 14.13 Realizimi i sulmit fizik i çdo personi ndaj cilitdo personi tjetër, me pasoja të rënda për shëndetin e viktimës: Përfundim përgjithmonë nga aktivitetet
- 14.14 Sjellja jo sportive e lojtarit të ekipit përfaqësues (kur ekipi është i grumbulluar) ndaj lojtarëve të tjerë, stafit të ekipit, zyrtarëve të FSHB-së apo personave të tjerë të përfshirë në përgatitjet dhe aktivitetin e ekipit (fyerje ofendime, etj): 30'000 lekë
- Në rast përsëritje, përfundim nga ekipi dhe 60'000 lekë
- 14.15 Braktisja e ekipit përfaqësues nga lojtari apo trajneri (largimi nga ekipi) pa arsye bindëse: Përfundim përgjithmonë nga ekipi kombëtar dhe 100'000 lekë

Shënim: Personi i penalizuar, pavarësisht kategorisë ku ai merr pjesë (të rritur/a apo moshat) nuk do të lejohet të aktivizohet deri në shlyerjen e detyrimit financiar dhe masës disiplinore. Pas përfundimit të sezonit sportiv, detyrimet financiare të pa shlyera do të njihen si detyrime të shoqatës dhe duhen shlyer nga shoqata përpara fillimit të sezonit të ardhshëm. Njëkohësisht, personi i penalizuar nuk do të regjistrohet për të marrë pjesë në aktivitete deri në shlyerjen e detyrimeve financiare (prej tij apo në emër të tij) dhe përfundimit të sanksionit disiplinor. Për lojtarët e ekipeve U14, sanksionet financiare aplikohen në masën 50%. Për lojtarët e ekipeve U12 dhe U10 nuk zbatohen sanksione financiare por vetëm disiplinore.

Neni 15 Gjyqtarët e lojës

Përpara fillimit të sezonit përkatës, FSHB do të hartojë dhe do të shpallë listën e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për t'u emëruar si arbitra të ndeshjeve të ardhshme të kampionatit.

FSHB ka të drejtën të heqë nga lista, emrin e çdo zyrtari ndeshjeje, në çdo kohë gjatë zhvillimit të sezonit.

FSHB do të emërojë zyrtarët e ndeshjes të cilët do të gjykojnë çdo ndeshje zyrtare.

Kur e shikon të arsyeshme, FSHB ka të drejtë të ndryshojë emërimin e zyrtarëve të ndeshjes.

Asnjë zyrtar ndeshjeje, i emëruar për gjykimin e ndonjë ndeshjeje zyrtare, nuk duhet të ndërmarrë ndonjë veprimtari tjetër, në ditën e ndeshjes, pa marrë më parë miratimin me shkrim nga FSHB.

Mosha e lejuar e gjyqtarëve të fushës është deri në 50 vjeç, konform rregullit ndërkombëtar të FIBA-s.

15.1 Një gjyqtar nuk mund të aktivizohet për të drejtuar ndeshje të aktiviteteve të FSHB-së n.q.s, nuk arrin të kalojë testin teorik dhe fizik.

15.2 Një gjyqtar nuk mund të aktivizohet për të drejtuar një ndeshje të aktiviteteve të FSHB-së pa paraqitur kartelën mjekësore dhe siguracionin sportiv.

15.3 Një gjyqtar i caktuar në një ndeshje zyrtare përfaqëson në fushë FSHB-në. Ai është përgjegjës për zbatimin e rregullores zyrtare të lojës. Nëse paraqitet në ndeshje me uniformë jo të rregullt (konform rregullores) dënohet me dy javë mos aktivizim.

15.4 Gjyqtari duhet të paraqitet në ambientet ku do të zhvillohet ndeshja një ora para fillimit të saj. N.q.s. një gjyqtar ka lajmëruar ardhjen e tij me vonesë, ai merr funksionet e tij që në ndalesën e parë të lojës. Paraqitja me vonesë në ndeshje, pa shkaqe të arsyeshme dhe/ose pa njoftuar, dënohet me një muaj mos aktivizim. Mos paraqitja në ndeshje, pa shkaqe të arsyeshme dhe pa lajmëruar, dënohet me një vit mos aktivizim.

15.5 Gjyqtari duhet të bashkëpunojë me organizatorët për të siguruar një zhvillim normal të ndeshjes. N.q.s. vëzhguesi nuk është prezent përpara fillimit të ndeshjes, gjyqtari duhet të kontrollojë liçensat dhe listën e lejuar të lojtarëve. Gjyqtari i parë, në bashkëpunim me vëzhguesin (nëse ka), duhet të mos lejojë qëndrimin në stol të personave të pa liçensuar, në të kundërt dënohet me 2 javë mos aktivizim.

15.6 N.q.s. një gjyqtar do të bëjë një raport mbi zhvillimin e ndeshjes, ai duhet ta bëjë atë menjëherë pas ndeshjes dhe ta dërgojë deri të nesërmen e ditës së zhvillimit të ndeshjes në zyrat e FSHB-së. Gjyqtari duhet të sigurohet që protokollin është plotësuar krejtësisht, në rregull dhe në 3 kopje, origjinali për federatën, kopja e dytë për skuadrën fituese, kopja e tretë humbësve. Mosdorëzimi në kohë i materialeve të ndeshjes si dhe plotësimi i pasaktë i protokollit dënohet me dy javë mos aktivizim.

15.7 Kryerja e detyrave nga gjyqtarët jo siç duhet dhe me përgjegjshmëri, duke manifestuar sjellje jo sportive dhe mospërfillje ndaj detyrave, dënohet me gjashtë muaj mos aktivizim.

15.8 Nëse konstatohet se gjyqtari ka konsumuar alkool, dënohet me një vit mos aktivizim.

15.9 Nëse konstatohet se gjyqtari gjykon dobët në ndeshje, dënohet me dy muaj aktivizim në kategori më të ulëta.

15.10 Nëse konstatohet shkelje të rregullores zyrtare të lojës që çojnë në përsëritjen e ndeshjes, dënohet me një vit mos aktivizim.

15.11 Nëse konstatohet se gjyqtari ndikon qëllimisht në rezultatin e ndeshjes, atëherë merren masa nga ulja për gjykim në kategoritë më poshtë deri në përjashtim përgjithmonë nga aktivitetet e FSHB-së.

15.12 Në rast përsëritje të pikës 15.11 atëherë ai përjashtohet përgjithmonë nga aktivitetet e F.Sh.B-së.

- 15.13 N.q.s. një gjyqtar humbet të drejtën për të gjykuar si rezultat i testimit, ai mund ta rifitojë këtë të drejtë vetëm pasi të ritestohet teorikisht e fizikisht.
- 15.14 Një gjyqtar nuk mund të ushtrojë një veprimtari tjetër në basketboll (si psh. Trajner, Vëzhgues apo drejtues i një ekipi).

Neni 16 Vëzhguesi

- 16.1 Vëzhguesi emërohet nga komisioni përkatës i federatës, për të siguruar zhvillimin e mirë të aktiviteteve të FSHB-së. Një vëzhgues nuk mund të aktivizohet n.q.s, nuk arrin të kalojë testin teorik. Mosha e lejuar e Vëzhguesit është deri në 70 vjeç, konform rregullit ndërkombëtar të FIBA.
- 16.2 Vëzhgues zgjidhen ata persona, që kanë integritet moral dhe profesional . Ata duhet të kenë njohje të mjaftueshme të rregullores zyrtare të lojës, statutit dhe rregulloreve të brendshme të FSHB-së. Vëzhguesit e ndeshjes, janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe dokumenteve të tjera operacionale, të vendosura në zbatim nga FSHB. Nëse paraqitet në ndeshje me veshje jo të rregullt (i detyrueshëm kostum) dënohet me dy javë mos aktivizim. Çdo zyrtar ndeshje duhet të njohë dhe të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë e tij duke nënshkruar një deklaratë ku merr përsipër zbatimin e përcaktimeve të:
- a) Rregullat e Lojës;
 - b) Rregullat e Federatës Shqiptare të Basketbollit;
 - c) Deklarimin me vërtetësi dhe në mënyrë të paanshme të të gjitha shkeljeve të përcaktimeve të kësaj rregulloreje, dhe të Kodit të Disiplinës Sportive, për të cilat zyrtari përkatës, konstaton personalisht gjatë ndeshjeve zyrtare ose verifikon gjatë këqyrjes së materialeve audio-video, të ndeshjeve ku ka marrë pjesë; Vëzhguesi duhet të mbërrijë në ambjentet e ndeshjes 60 minuta përpara orarit të fillimit të ndeshjes. Me të mbërritur në ambjentet ku zhvillohet ndeshja, vëzhguesi kontrollon ambjentet për skuadrën udhëtuese dhe zyrtarët e ndeshjes. Ai gjithashtu kontrollon uniformat e lojës, nëse janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullore, për të shmangur precedentët që mund të lindin, në rast ngjashmërie, ose ngatërrese të ngjyrës për ndeshje në shtëpi/jashtë. Ai kontakton me skuadrën udhëtuese dhe informohet nëq çdo gjë është në rregull apo nëse ka ndonjë problem (të cilin duhet ta raportojë në raport, nëse ka patur).
- 16.3 Në rast se një vëzhgues nuk kryen detyrën e ngarkuar në mënyrë të rregullt, në përputhje me statutin dhe rregulloret, atij mund t'i hiqet titulli i vëzhguesit, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm.
- 16.4 Vëzhguesi duhet të asistojë në ndeshjen për të cilën ai ka marrë emerim. Ai duhet të paraqitet në ambientet ku do të zhvillohet ndeshja një ora para fillimit të saj. Paraqitja me vonesë në ndeshje, pa shkaqe të arësyeshme dhe/ose pa njoftuar, dënohet me një muaj mos aktivizim. Mos paraqitja në ndeshje, pa shkaqe të arësyeshme dhe pa lajmëruar, dënohet me një vit mos aktivizim.
- 16.5 Vëzhguesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një zhvillim normal të ndeshjes. Ai duhet të vëzhgojë që ndeshja zhvillohet në përputhje me rregulloren zyrtare të lojës dhe rregulloret e FSHB-së. Për këtë qëllim, ai siguron bashkëpunim të plotë me gjyqtarët, gjyqtarinë e tavolinës, organizatorët dhe drejtuesit e ekipeve që marrin pjesë në këtë aktivitet. Në veçanti, ai duhet të insistojë tek organizatorët që forcat e ruajtjes së rendit, të jenë në numër të mjaftueshëm për të siguruar një zhvillim normal të ndeshjes. Vëzhguesi, në bashkëpunim me gjyqtarin e parë, duhet të mos lejojë qëndrimin në stol të personave të pa licensuar, në të kundërt dënohet me 2 javë mos aktivizim. Vëzhguesit e ndeshjes, të cilët nuk deklarojnë me vërtetësi dhe në mënyrë të paanshme shkeljet e verifikuara gjatë ndeshjeve ku marrin pjesë, ose neglizhojnë duke mos i deklaruar shkeljet që kanë konstatuar personalisht, do të sanksionohen me gjobë, më një vlerë jo më pak se 10'000 (dhjetë mijë) lekë, dhe pezullim nga pjesëmarrja në ndeshje, për një periudhë jo më pak se 3 (tre) muaj, për kundërvajtjen e parë, dhe do të sanksionohen me gjobë më një vlerë jo më pak se 50'000 (pesëdhjetë mijë) lekë, dhe pezullim nga pjesëmarrja në ndeshje për një periudhë jo më pak se 1 (një) vit, për kundërvajtjen e përsëritur.

- Gjatë zhvillimit të ndeshjeve zyrtare, ku marrin pjesë si të emëruar, vëzhguesit e ndeshjes janë të detyruar të mbajnë me vete nga një kopje të kësaj rregulloreje, dhe të Kodit të Disiplinës Sportive të FSHB-së.
- 16.6 Në rast të mungesës së një gjyqtari, vëzhguesi prezanton njërin gjyqtar, deri sa të mbërrijë kolegu i tij ose ai vazhdon të gjykojë ndeshjen i vetëm. N.q.s. vëzhguesi cakton një gjyqtar zëvendësues, ky gjyqtar zotëron të gjitha të drejtat e një gjyqtari të emëruar nga FSHB-ja.
- 16.7 Vëzhguesi është veçanërisht, përgjegjës për funksionimin e mirë të gjyqtarisë së tavolinës. Në fund të ndeshjes, ai harton një raport mbi zhvillimin e ndeshjes dhe bashkë me protokollin e ndeshjes, e dërgon, menjëherë në zyrat e FSHB-së.
- Vëzhguesi i ndeshjes, duhet të plotësojë raportin e ndeshjes, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas përfundimit të ndeshjes përkatëse, duke dhënë informacion si më poshtë:
- rreth kushteve të ambjenteve të vëna në dispozicion për zyrtarët e ndeshjes dhe skuadren mike;
 - rreth mbërritjes me vonesë të ndonjërit nga arbitrat e ndeshjes duke dhënë arsyet përkatëse;
 - rreth gjendjes dhe kushteve të fushës së lojës, aparaturave dhe mbatjes së statistikave.
 - nqs ndeshja fillon me vonesë, të informojë për arsyet e shkaktimit të vonesës për fillimin e ndeshjes përkatëse;
 - rreth masave ndëshkimore të vendosura ndaj lojtarëve gjatë zhvillimit të ndeshjes (nqs ka patur);
 - rreth zëvendësimit të arbitrit të ndeshjes nga ndonjë arbitër tjetër dhe shpjegimi për nevojën e kryerjes së këtij zëvendësimi;
 - rreth shkeljes së përcaktimeve të kësaj rregulloreje nga ndonjë shoqatë/klub, lojtar, zyrtar, manaxher, apo zyrtarët e tjerë të ndeshjes;
- 16.8 Vëzhguesi është përgjegjës për dërgimin e protokollit të ndeshjes, raportin e tij dhe protestave eventuale në FSHB brenda 48 orëve nga përfundimi i ndeshjes. Ai, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, duhet të dërgojë rezultatin e ndeshjes dhe ndonjë përshkrim për rastet e veçanta, personit të caktuar nga FSHB-ja për këtë qellim. Moszbatimi i këtij rregulli, dënohet me dy javë mos aktivizim. Vëzhguesit e ndeshjes janë të detyruar të raportojnë pranë organeve juridike të FSHB-së, çdo shkelje të Kodit të Disiplinës Sportive, ose të kësaj rregulloreje, që ata verifikojnë ose janë dëshmitarë para ndeshjes, gjatë ndeshjes, dhe pas ndeshjes përkatëse ku janë emëruar si zyrtarë të ndeshjes.
- 16.9 Kur një lojtar, trajner, drejtues i ekipit apo çdo person tjetër i lidhur me ndeshjen, kryen një shkelje që mund të dënohet, vëzhguesi duhet të bëjë një raport me shkrim drejtuar FSHB-së pas përfundimit të ndeshjes.
- Mospërmbushja e përgjegjësisë të përcaktuara këtu në këtë Nen nga ana e zyrtarëve të ndeshjes, nuk i jep të drejtën ndonjë klubi, lojtari apo kujtdo personi tjetër, që të shkelë detyrimet apo të mos përmbushë përgjegjësitë individuale të përcaktuara këtu në këtë rregullore.
- 16.10 Nëse konstatohet kryerja e detyrave nga vëzhguesi jo siç duhet dhe me përgjegjshmëri, duke manifestuar sjellje jo sportive dhe mospërfillje ndaj detyrave, dënohet me gjashtë muaj mos aktivizim.
- 16.11 Mosparaqitja e fakteve të ndeshjes ashtu siç kanë ndodhur në të vërtetë, dënohet me gjashtë muaj mos aktivizim.
- 16.12 Nëse konstatohet se vëzhguesi ka konsumuar alkool, dënohet me një vit mos aktivizim.
- 16.13 Nëse konstatohet shkelje të rregullores zyrtare të lojës që çojnë në përsëritjen e ndeshjes, dënohet me një (1) vit mos aktivizim.
- 16.14 N.q.s. një vëzhgues humbet të drejtën për të vëzhguar si rezultat i testimit, ai mund ta rifitojë këtë të drejtë vetëm pasi të ritestohet.
- 16.15 Në rast se në ndeshje nuk është caktuar ndonjë vëzhgues, këtë detyrë e kryen gjyqtari i parë.
- 16.16 Nuk lejohet që brenda një sezoni sportiv, një vëzhgues të transferohet në trajner dhe anasjelltas, kërkesa për tu angazhuar si vëzhgues duhet të bëhet në fillim të sezonit duke deklaruar pozicionimin e tij/saj.

Neni 17 Gjyqtaria e tavolinës

- 17.1 Gjyqtarët e tavolinës (sekretari, kronometristi, mbajtësi i 24 sekondave dhe pikëshënuesi) emërohen nga anëtarë organizator. Këta duhet të jenë kompetentë dhe të punojnë pa anësi. Ata duhet të paraqiten në vendin e zhvillimit të ndeshjes të paktën 30 min para fillimit të saj. Anëtarë organizator është përgjegjës për punën e mirë të gjyqtarisë së tavolinës. Mos sigurimi i gjyqtarisë së tavolinës, gjobitet me 5'000 lekë. Mos sigurimi i gjyqtarisë së tavolinës, që çon në moszhvillimin e ndeshjes, gjobitet me 100'000 lekë dhe humbjen e ndeshjes aforfe.
- 17.2 Gjyqtarë tavoline kanë të drejtë të jenë vetëm ata persona të cilët kanë kaluar testimin përkatës të organizuar nga FSHB-ja dhe janë pajisur me liçensën përkatëse.
- 17.3 Emrat e gjyqtarëve, vëzhguesit dhe gjyqtarëve të tavolinës duhet të figurojnë në protokoll.
- 17.4 N.q.s. anëtarë organizator nuk arrin të sigurojë gjyqtarinë e tavolinës për ndeshjen që organizon, vëzhguesi dhe gjyqtarët duhet të bëjnë të pamundurën për zhvillimin e ndeshjes duke relatuar për këtë problem. Anëtarë organizator i ndeshjes i nënshtrohet sanksioneve financiare.
- 17.5 Nëse me gjithë përpjekjet ndeshja nuk zhvillohet, krahas sanksionit financiar për mossigurimin e gjyqtarisë së tavolinës, anëtarë organizator humbet ndeshjen aforfe, duke ju nënshtruar edhe sanksioneve financiare e disiplinore që lidhen me moszhvillimin e ndeshjes.

NENI 18 Protokollin e ndeshjes

- 18.1 Protokollin e ndeshjes është ai i miratuar nga F.Sh.B-ja. Plotësimi i tij bëhet mbështetur në rregulloren zyrtare të lojës.
- 18.2 Protokollin e ndeshjes duhet të mbahet në 3 (tre) kopje, kopja e parë për FSHB-në, kopja e dytë për fituesin dhe kopja e tretë për ekipin humbës.
- 18.3 Një lojtar që nuk është regjistruar në protokoll, nuk mund të marrë pjesë në ndeshje.
- 18.4 Vetëm rezultati i pasqyruar në protokoll njihet si rezultat zyrtar i ndeshjes.
- 18.5 Protokollet e ndeshjeve sigurohen nga FSHB-ja. Ato ju shpërndahen shoqatave sipas nevojës, me kërkesën e tyre. Në mungesë të protokollit ndeshja nuk zhvillohet dhe ekipi pritës humbet ndeshjen aforfe.
- 18.6 Për kampionatet kombëtare U20/U18/16 djem dhe vajza nga hyrja në fuqi të kësaj rregulloreje krahas mbatjes së protokollit të ndeshjes zyrtare, do të aplikohet dhe mbatja e protokollit dixhital nëpërmjet aplikacionit (InGame App) i ofruar nga kompania NBN23.

Neni 19 Dispozitat financiare

- a. Kuotizacioni vjetor i anëtarësimit në FSHB për anëtarët:
- 3'000 lekë
- b. Kuota e pjesëmarrjes në aktivitetet e F.Sh.B-së për çdo ekip të meshkujve (përfshi regjistrimin e 18 lojtarëve dhe 2 trajnerëve):
- 200'000 lekë

- c. Kuota e pjesëmarrjes në aktivitetet e F.Sh.B-së për çdo ekip të femrave (përfshi regjistrimin e 18 lojtarëve dhe 2 trajnerëve): 100'000 lekë
- ç. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U20 djem: 0 lekë
- d. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U20 vajza: 0 lekë
- dh. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U18 djem: 100'000 lekë
- e. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U18 vajza: 50'000 lekë
- ë. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U16 djem: 100'000 lekë
- f. Kuota e regjistrimit për çdo ekip U16 vajza: 30'000 lekë
- g. Kuota e regjistrimit për çdo ekip të moshave nën 12 vjeç, (përfshi regjistrimin e 18 lojtarëve dhe 2 trajnerëve), brenda afatit të përcaktuar: 3'000 lekë
- Shënim:** Kuota e pjesëmarrjes në aktivitete për ekipet e moshave nën 14 vjeç, do të përcaktohet për çdo aktivitet të veçantë, përpara fillimit të tij.
- gj. Kuota e regjistrimit për çdo lojtar mbi numrin 18 (zëvendësim brenda afateve të përcaktuara):
- për ekipet e meshkujve 2'000 lekë
 - për ekipet e femrave 1'500 lekë
 - për ekipet e moshave nën 20 dhe 18 vjeç djem 1'000 lekë
 - për ekipet e moshave nën 20 dhe 18 vjeç vajza 800 lekë
 - për ekipet e moshave nën 16 vjeç djem dhe vajza 500 lekë
- h. Kuota e regjistrimit për çdo lojtar pas datës së përcaktuar deri në fund të muajit dhjetor është 10-fishi i shumës së përshkruar në pikën gj. Kuota e regjistrimit me një ekip të dytë dhe/ose të tretë për çdo lojtar, brenda afateve të përcaktuara, do të jetë 5 fishi i shumës së përshkruar në pikën gj.
- i. Kuota e regjistrimit për shoqërues ekipi, mjek, fizioterapist, gjyqtar, gjyqtar tavoline, vëzhgues: 1'500 lekë
- j. Tarifa e transferimit të lojtarëve nga një shoqatë në një tjetër, në mungesë të kontratës, ose pas përfundimit të saj:
- për transferimet në ekipet e meshkujve: 80'000 lekë
 - për transferimet në ekipet e femrave: 40'000 lekë
 - për transferimet në ekipet U20 dhe U18 djem: 30'000 lekë
 - për transferimet në ekipet U20 dhe U18 vajza: 15'000 lekë
 - për transferimet në ekipet e moshave nën 16 vjeç: 10'000 lekë

**40% e të ardhurave të caktuar në nenin 19.j shkojnë për FSHB-në dhe 60% për ekipin nga transferohet lojtari/a.*

**Tarifa e transferimit të lojtarëve/eve që kanë mbushur moshën 18 apo 19 vjeç, ose do të mbushin moshën 18 apo 19 vjeç deri në fund të muajit dhjetor të edicionit në vazhdim, do të jetë 50% më pak se vlera e përcaktuar për transferim në ekipet të rritur/a.*

k. Tarifa e transferimit të lojtarëve të huaj nga një federatë e huaj në Shqipëri, ose nga një shoqatë anëtare në një tjetër:

- Për dy lojtarët e parë të regjistruar gjatë një edicioni sportiv do të jetë **1200 euro** për kampionatin kombëtar meshkuj të rritur, ndërsa për kampionatin kombëtar femra të rritura do të jetë **600 euro**.
*Për çdo lojtarë/e të regjistruar pas lojtarit/es të dytë gjatë një edicioni sportiv, vlera e regjistrimit do të rritet me 50% më shumë se vlera e regjistrimit të lojtarit/es pararendës/e.
Më poshtë shembull për llogaritjen e vlerës së regjistrimit për lojtarët e huaj të regjistruar në kampionatin kombëtar meshkuj pas dy lojtarëve të parë gjatë një edicioni sportiv:
Për regjistrim të lojtarit të tretë, vlera do të jetë **1200 euro + 50% e 1200 euro = 1800 euro**
Për regjistrim të lojtarit të katërt, vlera do të jetë **1800 euro + 50 % e 1800 euro = 2700 euro**
Për regjistrim të lojtarit të pestë, vlera do të jetë **2700 euro + 50 % e 2700 euro = 4'050 euro**
Etj.
**Me të njëjtën formulë do të llogariten dhe transferimet e lojtareve të huaja në kampionatin kombëtar femra të rritura.*
- Për transferimet në ekipet e moshave nën 18 dhe 16 vjeç, djem: 350 euro
- Për transferimet në ekipet e moshave nën 18 dhe 16 vjeç, vajza: 200 euro

l. Tarifa e ri-regjistrimit të lojtarëve të huaj, në ekipet e të njëjtës shoqatë:

- për ri-regjistrimit në ekipet e meshkujve 300 euro
- për ri-regjistrimit në ekipet e femrave 200 euro

ll. Tarifa e transferimit të lojtarëve shqiptarë nga federatat e huaja në Shqipëri do të jetë si në pikën **k** (pa përfshirë rritjen progresive).

m. Tarifat e gjyqimit, gjyqtarëve të tavolinës dhe vëzhguesve për ndeshjet e aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga FSHB-ja:

- Vëzhguesit 5'000 lekë
- Gjyqtarët :
 - Meshkuj të rritur - Superligë 9'000 lekë
 - Meshkuj të rritur – Kategoria I-rë 7'000 lekë
 - Femra të rritura 7'000 lekë
 - U20/18/16 djem dhe vajza 3'000 lekë
 - U14/12/10 djem dhe vajza 1'500 lekë
- Gjyqtaria e tavolinës (ndeshjet e organizuara nga FSHB-ja)
 - Meshkuj, femra (të rritur), U20/18/16/14 1,000 lekë
 - U12 djem, U12 vajza, U10 miks me grumbullim 500 lekë

n. Shpërblimi për fituesit e trofeve të FSHB-së:

• Kampion Kombëtar Meshkuj (të rritur)	700'000 lekë
• Ekipi Finalist i Kampionatit Kombëtar Meshkuj (të rritur)	300'000 lekë
• Kampion Kombëtar Femra (të rritura)	400'000 lekë
• Ekipi Finalist i Kampionatit Kombëtar Femra (të rritura)	200'000 lekë
• Fitues i Kupës së Shqipërisë Meshkuj (të rritur)	300'000 lekë
• Ekipi Finalist i Kupës së Shqipërisë Meshkuj (të rritur)	150'000 lekë
• Fitues i Kupës së Shqipërisë Femra (të rritura)	200,000 lekë
• Ekipi Finalist i Kupës së Shqipërisë Femra (të rritura)	100'000 lekë
• Fitues i Superkupës së Shqipërisë meshkuj/femra (të rritur/a)	150,000 lekë
• Kampion Kombëtar U20 Djem	100'000 lekë
• Kampion Kombëtar U18 Djem	200'000 lekë
• Kampion Kombëtar U18 Vajza	200'000 lekë
• Kampion Kombëtar U16 Djem	200'000 lekë
• Kampion Kombëtar U16 Vajza	100'000 lekë

***Shënim:** Në rastin e organizimit të Superligës Meshkuj dhe Kategorisë së I-rë Meshkuj, tarifat e pjesëmarrjes dhe transferimeve të përcaktura për Kampionatin Kombëtar Meshkuj do të jenë të njëta për Superligën, ndërsa për Kategorinë e I-rë Meshkuj do të jenë 20 % më pak. Gjithashtu, do të ketë shpërblim për ekipin fitues të Kategorisë së I-rë Meshkuj në vlerën 100'000 lekë.

Neni 20 Anti-Doping

Çdo klub duhet të mbajë në funksionim një dhomë për kryerjen e kontrollit ose analizave anti-doping, e cila duhet të ndodhet pranë dhomave të zhveshjes së lojtarëve dhe dhomës së zyrtarëve të ndeshjes. Dhoma e kontrollit anti-doping nuk duhet të jetë e hapur për gazetarët, median, dhe publikun.

- Lojtari që nuk pranon të kryejë kontrollin anti-doping, (konsiderohet sikur të ketë marrë substanca të ndaluara) dhe pezullohet nga ndeshjet për një periudhë nga 6 (gjashtë) muaj deri në 2 (dy) vjet, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 200,000 (njëqind mijë) lekë dhe të paguajë të gjitha shpenzimet e analizave.
- Lista e substancave të ndaluara është e publikuar në WADA për çdo vit kalendarik.
- Lojtari/ja që do të testohet mund të njoftohet 12 orë përpara ndeshjes, deri në 4 orë pas përfundimit të saj.
- Në rastet kur një shoqatë/klub, ngre dyshime për ndonjë lojtar/e, duhet të depozitojë në FSHB një letër me shkrim, ku përshkruan me fakte, situatën për të cilën dyshon (është Federata ajo që do të miratojë ose jo kërkesën, në varësi të fakteve të vëna në dispozicion). Shoqata që ka bërë kërkesën, do të mbulojë shpenzimet financiare nëse nuk konfirmohet si i vërtetë pretendimi i ngritur, në rast të kundërt shoqatës/klubit ku lojtari rezulton pozitiv, i ngarkohen shpenzimet dhe penalitetet që rrjedhin për këtë qëllim.
- Në rastet kur FSHB kërkon të realizojë testet, ajo do të mbulojë shpenzimet financiare të testimit.

Neni 21 Etika

Etika e sjelljes dhe Integritetit zbatohet për të gjithë ata që marrin pjesë në sportin e basketbollit nën drejtimin e Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Të gjithë individët, zyrtarët, shoqatat dhe klubet sportive kanë përgjegjësinë të veprojnë sipas standardeve më të larta të integritetit dhe të sigurojnë që reputacioni i basketbollit të mbetet i pacënueshëm.

Federata Shqiptare e Basketbollit është e interesuar dhe angazhuar për ruajtjen e standarteve më të larta të mundshme të sjelljes gjatë gjithë kohës së zhvillimit të aktiviteteve basketbollistike. Parimet duhet të respektohen gjithmonë në mënyrë që basketbolli të transmetojë vlerat më të mira dhe të japë kënaqësi për të gjithë. Parimet e etikës dhe integritetit në basketboll:

- Të gjitha shoqatat, klubet që merren me basketboll duhet t'i trajtojnë të gjithë në mënyrë të barabartë dhe të kujdesshme pavarësisht moshës, aftësive të kufizuara intelektuale apo fizike, gjinisë, racës, origjinës etnike, prejardhjes kulturore apo sociale, orientimit seksual, besimit fetar, përkatësisë politike, apo ndonjë karakteristikë/veçori tjetër personale.
- Federata Shqiptare e Basketbollit është kundër çdo forme të sjelljes së dhunshme, ofenduese ose diskriminuese dhe do të veprojë sipas nevojës dhe situatave për të shmangur ose larguar nga basketbolli sjellje apo individë që bien ndesh me Etikën dhe Integritetin sportiv.
- Kushdo që përfshihet në sportin e basketbollit, si të rriturit ashtu edhe të rinjtë kanë përgjegjësinë t'i trajtojnë të gjithë me kujdes, dinjitet, respekt dhe drejtësi.
- Kushdo që merr pjesë në lojën e basketbollit, duhet të ketë një mjedis të këndshëm, të sigurt dhe të mbrohet nga abuzimi.
- FSHB është përgjegjëse për mbrojtjen e integritetit dhe reputacionit të basketbollit në Republikën e Shqipërisë dhe përpaket vazhdimisht të mbrojë imazhin e basketbollit nga cënimi ose dëmi që mund të shkaktohet, si rezultat i metodave dhe praktikave të paligjshme.
- Çdo individ, sportist apo trajner, që është i licensuar në Federatën Shqiptare të Basketbollit dhe merr pjesë në aktivitetet që ajo zhvillon, e ka për detyrë të përgjigjet me korrektësi dhe në kohë të gjitha thirrjeve që FSHB i adreson në lidhje me aktivitetet ndërkombëtare në të gjitha kategoritë dhe moshat. Mosrespektimi i kësaj detyre, pa arsye bindëse dhe të justifikuara, automatikisht i privon ata nga të gjitha veprimtaritë e FSHB-së.

Në kuadër të rregullores së FIBA-s, FSHB vendos në faqen zyrtare www.fshb.basketball informacionin mbi personin kontaktit (SPOC – Single Point of Contact) dhe formën e raportimit anonim për çeshtjet e shkeljes së Etikës dhe Integritetit në aktivitetet kombëtare të basketbollit në Shqipëri.

Të gjitha rastet që nuk parashikohen në këtë rregullore, rregulloren e FIBA Europe apo rregulloren zyrtare të lojës (FIBA), do të zgjidhen nga FSHB-ja. Në të gjitha rastet kur afatet, nuk janë plotësisht të detajuara (datë dhe orë), merren në konsideratë ditët dhe orët kur zyra është e hapur (orari zyrtar).

Neni 22 Dispozita kalimtare

Kjo rregullore, hyn në fuqi më fillimin e sezonit të ri sportiv **2025 – 26.**

Me hyrjen në fuqi të saj, rregulloret e mëparshme shfuqizohen.